



Breaking News:

Gjirokastër – Ushtri dhunë fizike dhe psikologjike ndaj vajzës së tij të mitur, vihet në pranga 41-vjeçari

⏏ ⏪ ⏩



03/05/2023

Shkodër – Autori I Vrasjes Së Shtetasit P. V., U Lokalizua Në Një Banesë Ku Ishte Strehuar Pasi Kishte Kërcënuar Pronaren E Kësaj Banese

Pas 21 orësh kërkime dhe ndjekje, lokalizohet, kapet dhe vihet në pranga autori i dyshuar i vrasjes së kryer mesditën e djeshme, në lagjen “Tom Kola”.

Gjendet dhe sekuestrohet arma e zjarrit automatik me të cilën dyshohet se u krye vrasja.

Strukturat operacionale të DVP Shkodër dhe ato të Komisarariatit të Policisë Shkodër, në bashkëpunim me Forcën Speciale RENEa, pasi 21 orësh, si rezultat i kërkimeve dhe ndjekjes së pandërprerë policore, me mbështetjen e informacioneve të siguruara nga inteligjenca informative, kanë bërë të mundur lokalizimin, kapjen dhe vënien në pranga të shtetasit L. V., 34 vjeç, banues në Shkodër.

34-vjeçari u lokalizua në banesën e një shtetaseje, në rrugën “Pjetër Budi”, Shkodër, banesë në të cilën kishte mundur të strehohej pasi gjatë natës kishte kërcënuar pronaren e kësaj banese për t’i hapur derën dhe për të mos kallëzuar.

Gjithashtu, në të njëjtën banesë, u gjet edhe arma e zjarrit automatik me të cilën dyshohet se autori kreu vrasjen.

Shtetasi L. V. dyshohet se rreth orës 12:15, të ditës së djeshme, në lagjen “Tom Kola”, vrau me armë zjarri automatik, në banesë, shtetasin P. V., 51 vjeç.

Grupi hetimor, në drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, vijon punën për dokumentimin e plotë ligjor të këtij rasti.

Kërko

Enter a word for search

Q

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

> Arkiva

> Akademia e Sigurisë

> Ministria e Brendshme

> Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

> Interpol

> Europol

> Misioni PAMECA V

> SCPA

> Projekti Trivalent